REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 852120
Datë/Datum. 06.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	27.10.2020	06.11.2020

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.10.2020, OE "Kompania e Sigurimeve Prisig" Sh.a., ka parashtruar ankesë me nr: 852/20, kundër njoftimi për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Sigal Uniqa Group Austria", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sherbimet e Sigurimit Shëndetësor per Stafin e NP "TERMOKOS"Sh.a", me nr. të prokurimit: 20-3991-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Termokos Sh.a.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 79,200.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 27.07.2020, data e hapjes së ofertës: 18.08.2020, data e vendimit për dhënien e kontratës: 12.10.2020, data e njoftimit të me letër standarde: 12.10.2020.
Ankesa është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues ne ankesen e tij pretendon se AK-ja, pa te drejte e ka eliminuar dhe njeherit ne ankesen e tij i ka dhene argumentet duke pretenduar se e ploteson kerkesen per te cilen eshte eliminuar dhe lidhur me rezultatet e vleresimit te AK-se, OE ankues pretendon se AK-ja, nuk i ka respektuar nenin: 1, 6, 7, 56, 59, 60 dhe 62 te LPP-se dhe njeherit pretendon se AK-ja, nuk i ka zbatuar procedurat e parapara ne nenin 61 te LPP-se dhe rregulloren per cmime jo normalishte te uleta.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kapaciteti Teknik dhe Profesional:
Kerkesa:
Paisja me Kartela shendetsore per shfrytzim ne rrjete te klinikave.

Deshmia:
Deshmi se kompania ofron kartela per klinika qe bashkpunon.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
OE ankues është i papërgjegjshëm
OE i rekomanduar per kontratë është i përgjegjshëm

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues, eshte njoftuar nga autoriteti kontraktues si tenderues i eliminuar dhe njeherit ne sqarimin e dhene ne letren standarde te OE ankues thuhet se:

- Nuk ka ofruar deshmi se posedon kartela shendetsore e cila ka qene kerkese e DT-se dhe
- Sipas formules se rregullores per cmimie jo normalishte te uleta, oferta e OE ankues rezulton te jet oferte me cmim jo normalishte te ulet.

Eksperti shqyrtues, sa i perket arsyes se pare te eliminimit, sqaron se ky pretendim eshte trajtuar ne raportin e pare te ekspertizes, per te cilen eksperti shqyrtues, ka dhene nje pergjigje poashtu e njoftoj panelin shqyrtues, konform rregullores se punes se ky pretendim eshte trajtuar edhe me vendimin me nr: 625/20.
Prandaj ky pretendim eshte pjeserisht i qendrueshem per faktin se AK-ja, perkunder udhezimeve te dhena ne vendimin e PSH-se, nuk e ka trajtuar kete pretendim.

Sa i perket arsyes se dyte te eliminimit, eksperti shqyrtues, sqaron se gjate rivlersimit te ketij aktiviteti te prokurimit, AK-ja, konform rregullores per cmime Jo/Normalishte te uleta ka bere llogaritjen sipas tabeles se dhene ne kete rregullore dhe ne fund ka rezultuar qe pragu te jet: 55,911.23€.

OE ankues "Pri Sig", me cmimin e dhene ne oferten e tij (50,922.00) e ka plotesuar kushtin per tu konsideruar ofert me cmim Jo/Normalishte te ulet per faktin se pragu per tu konsideruar ofert me cmim Jo/Normalishte te ulet eshte 55,911.23€.

Eksperti shqyrtues, lidhur me formulen e nxjerr nga autoriteti kontraktues, sqaron se edhe pas llogaritjes e konfirmoj te njejten vlere: 55,911.23€, qe do te thot se pragu per tu konsideruar si oferte me cmim Jo/Normalishte te ulet eshte vlera e lartshenuar.

Lidhur me kete ceshtje OE ankues pretendon se autoriteti kontraktues, nuk i ka zbatuar te gjitha procedurat e parapara Rregulloren per cmime Jo/Normalishte te uleta, me arysetimin se autoriteti kontraktues nuk i ka ndjekur procedurat e parapara ne nenin 4 te kesaj rregulloreje.

Ne Rregulloren per cmime Jo/Normalishte te uleta ,e nenin 4 thuhet:

4.1 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 te LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 te këtyre rregullave, një tender i tille **nuk mund të refuzohet** pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues **duhet të kërkoj me shkrim** nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja ***"Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".***

Duke u bazuar ne shkresat e lendes, eksperti shqyrtues vlereson se AK-ja, nuk i ka zbatuar ne teresi procedurat e parapara ne nenin 4 te rregullores se lartpermendur, per faktin se pavarsishte se OE ankues e ka plotesuar kushtin per tu konsideruar ofert me cmim Jo/Normalishte te ulet, perjashtimi automatik eshte i ndaluar ne nenin 4.1 te kesaj rregulloreje.

Pra, nuk mund te eliminohet pa hetimin dhe shqyrtimin e cmimit te dhene nga nje operatori ekonomik, qe do te thot se AK-ja, eshte e obliguar qe te veproj sipas paragrafit 1 dhe 2 te nenit 4 te Rregullores per cmime Jo/Normalishte te uleta. Prandaj, eksperti shqyrtues vlereson se ky pretendim i OE ankues eshte i qendrueshem per faktin se autoriteti kontraktues nuk ka kerkuar sqarim me shkrim lidhur me cmimin e dhene nga OE ankues.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjeserisht pjeserisht e bazuar, ndersa vendimi i AK-së për dhënie te kontrates te anulohet dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – PRI SIG.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - TERMOKOS Sh.a.